



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 742/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga, Kimete Gashi Kryetare e panelit Shqyrtues, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik, OE "Pro Medical" sh.p.k me seli në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për laboratorë të shkollave për Lot- I Furnizim me pajisje për laborator të shëndetësisë", me nr. të prokurimit: 632-22-11151-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Gjakovë, më datën 15.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar, ankesa e operatorit ekonomik, "ProMedical" sh.p.k me seli në Ferizaj, nr.742/22, përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për laboratorë të shkollave për Lot- I Furnizim me pajisje për laborator të shëndetësisë", me nr. të prokurimit: 632-22-11151-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Komuna Gjakovë.

II. Mbetet në fuqi, njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 17.11.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje për laboratorë të shkollave për Lot- I Furnizim me pajisje për laborator të shëndetësisë", me nr. të prokurimit: 632-22-11151-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna Gjakovë.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraparak të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/ L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

V. Konfiskohet tarifa për ankesë e OE“Pro Medical” sh.p.k, konfom nenit 31 pika 5 të rregullores së punës së OSHP dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 05.12.2022,ka pranuar ankesë nga “Pro Medical” sh.p.k për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje për laboratorë të shkollave për Lot- I Furnizim me pajisje për laborator të shëndetësisë, me nr. të prokurimit: 632-22-11151-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna Gjakovë, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 742/2022.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur - furnizim, vlerë e mesme, kriteri i dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimi më të ulët vlera e parashikuar e kontratës: 16,705.00 €, ndërsa për LOT - I është vlera e parashikuar: 11,980.00 €.

Për aktivitetin prokurimit në fjalë Autoriteti Kontraktues me datën 17.11.2022,ka publikuar B58 Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE “Infinit” sh.p.k Prishtinë.

Me datë 22.11.2022,OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 24.11.2022-Komuna Gjakovë, e refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik “Pro Medical” sh.p.k për aktivitetin e prokurimi të sipër shënuar dhe ka vërtetuar B58 Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 17.11.2022.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 16.12.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE ankues “Pro Medical” sh.p.k të refuzohet si e pa bazuar,
- të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 17.11.2022(vendim për dhënie të kontratës).

-Seanca dëgjimore

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësit e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Pro Medical” sh.p.k

Pretendimi kryesor ankimor ka të bëjë kundër propozimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, AK ka rekomanduar për kontratë OE “Infinit” sh.p.k”.

Përgjigje në Pretendime:

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik “Pro Medica” Ferizaj, si parashtrues i ankesës pretendon se AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE “Infinit” sh.p.k i cili nuk ka Licencën për shitjen e pajisjeve mjekësore. Pas shqyrtimit të dosje së tenderit të cilën e ka ngrit AK në platformën elektronik tek kërkesa (FTD) Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk është kërkuar një licencën nga AKPPM në dosjen e tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin konform nenit 59 të LPP-së, duke u bazuar në nenin 27 dhe 52 të LPP-se, ku i ka përpiluar njoftimin për kontratën dhe dosjen e tenderit dhe ka vendosur kriteret. Për vendosjen e kriterëve në FDT është përgjegjësi e autoritetit kontraktues, asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekte tjera të tenderit nuk mund të kërkohej apo të ndryshohet, ofrohet ose lejohet.

Përgjigje në Pretendime:

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik “Pro Medical” Ferizaj, si parashtrues i ankesës pretendon se AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE “Infinit” sh.p.k i cili nuk ka ofruar certifikatën e regjistrimit të biznesit me veprimtari specifike për pajisje mjekësore.

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin konform nenit 59 të LPP-së dhe konform kërkesave në dosjen e tenderit, pasi që nga AK nuk është kërkuar veprimtari specifike por vetëm certifikata e regjistrimit të biznesit.

Andaj, mendimi i ekspertit shqyrtues, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor e vlerëson si të pabazuar pretendimin e OE në fjalë, pasi që AK nuk ka kërkuar një licencë nga AKPPM në dosjen e tenderit dhe veprimtari specifike për këtë aktivitet të prokurimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të merret si e pabazuar dhe Vendimi mbi autoritetin kontraktues të mbetet në fuqi.

Sa i për këtë pretendimit, operatori ekonomik OE ankues “Pro Medica” Ferizaj, i cili pretendon se AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE “Infinit” sh.p.k i cili nuk ka Licencën për shitjen e pajisjeve mjekësore, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të dosje së tenderit të cilën e ka ngrit AK në platformën elektronik tek kërkesa (FTD) Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale konstaton se nuk ka kërkuar një licencën nga AKPPM në dosjen e tenderit.

Paneli vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin konform nenit 59 të LPP-së, duke u bazuar në nenin 27 dhe 52 të LPP-se, ku i ka përpiluar njoftimin për kontratën dhe dosjen e tenderit dhe ka vendosur kriteret. Për vendosjen e kriterëve në FDT është përgjegjësi e autoritetit kontraktues, asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekte tjera të tenderit nuk mund të kërkohej apo të ndryshohet, ofrohet ose lejohet.

Ndërsa sa i për këtë pretendimit tjetër ankimore, të operatori ekonomik “Pro Medical” Ferizaj, i cili pretendon se AK ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE “Infinit” sh.p.k i cili nuk ka ofruar certifikatën e regjistrimit të biznesit me veprimtari specifike për pajisje mjekësore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Autoriteti Kontraktues e ka bërë vlerësimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së dhe konform kërkesave në dosjen e tenderit, pasi që AK nuk ka kërkuar një licencë nga AKPPM në dosjen e tenderit dhe veprimtari specifike për këtë aktivitet të prokurimit por vetëm certifikata e regjistrimit të biznesit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete, rekomandimeve të ekspertit të jashtëm shqyrtues, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi vlerëson se ankesa e OE ankues, “Pro Medical” sh.p.k, të refuzohet si e pa bazuar dhe që të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 17.11.2022, pasi që paneli vlerëson se AK ka bërë vlerësimin e ofertave konform nenit 59 të LPP-së, duke u bazuar në nenin 27 dhe 52 të LPP-së.

Vendimi sikurse në pikën 3, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues
Kimete Gashi



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Komuna Gjakovë
- 1x1 OE "Pro Medical" sh.p.k me seli në Ferizaj
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.